



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LIGJISLATURA IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës të Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 7
Prishtinë, më 6 qershor 2011
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-302

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENSHME, SIGURI DHE
MBIKQYRJËN E FORCËS TË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selimi, Fatmir Xhelili, Ganimete Musliu, Goran Marinković, Anton Quni, Vjollca Krasniqi dhe Rasim Demiri, anëtarë të Komisionit.

Nga Zyra Mbështetëse morën pjesë: Nur Çeku, Antigona Ibraj dhe Haxhi Xhemajli.

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Diskutim në lidhje me memorandumun në mes MBP- së dhe MFSK- së

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e rendit të ditës.

Kryetari- Të nderuar koleg, arsyeja pse e kemi ftuar këtë mbledhje urgjente sot është që të sqarohet lidhur me disa shqetësime në opinion dhe për ne, si anëtarë të Komisionit dhe ta marrim një qëndrim në lidhje me një takim që do t'i ftojme ministrat e MBP- së dhe të FSK- së. Pra, siç e kemi parë në media ka dalë një memorandum i përgatitur midis dy ministrave, i cili ka sjellë konfuzion në opinion dhe ne jemi këtu për ta sqaruar. Ne, si komision, nuk e kemi ende një dokument të tillë zyrtar, por për ta mbyllur këtë çështje kemi kontaktuar me dy ministrat dhe i kemi ftuar të mërkurën në orën dhjetë. Po ashtu ,pasi që nuk kemi dokument zyrtar, kisha kërkuar që si Komision të përmbahemi deri të mërkurën, para mediave, nëse na kërkohet të flasim në këtë bazë, që të mos krojohet konfuzion deri sa të mos i dëgjojmë dy ministrat.

Rexhep Selimi- Unë nuk dua ta përsëris atë çka u tha deri më tash, por dua të lidhem me kërkesën e denoncimeve dhe pajtohem që të jemi të përmbajtur, jo për shkak të ndonjë censure, por për shkak se ne, si Komision, nuk kemi ende informata zyrtare për memorandumun në fjalë. Unë deri më tani kam qenë i përmbajtur pikërisht pse nuk e kemi një draft zyrtar. Kërkesa e juaj për t'i ftuar dy ministrat është e duhur dhe besoi se do të na i japin të gjitha sqarimet e nevojshme, për të gjitha konfuzionet e përhapura në media.

Fatmir Xhelili- Ftesa për këtë takim më është dukur e çuditshme, duke e ditur që nuk kemi dokument zyrtar dhe gjithçka rrjedh nga mediat, por tani po e shoh që ky takim qenka i duhur. Për zbatimin e politikave të sigurisë janë MPB dhe MFSK, të cilat punojnë bazuar në ligjet përkatëse. Plani i reagimit kombëtar, qartë i definon, i identifikon, i orienton dhe i cakton kohërat e kyçjes së secilit segment, në situata të menaxhimit të emergjencave, andaj edhe FSK – ja e ka vendin e vet në këto situata. Duke u bazuar në punën e deritashme të FSK- së dhe në seriozitetin dhe përvojën e ministrit të FSK- së, në politikat e sigurisë, unë mendoj që e gjithë kjo është keqkuptim, ose ka një tentim për të na qitur në lajthitje me propozim- draftin, që kinse po përgatitet. Pyetja këtu lind, iniciativa e kujt është kjo marrëveshje dhe cili është qëllimi i saj. Në qoftë se është prej FSK- së, atëherë unë mendoj se ka për qëllim që FSK- ja, të fitoj edukim, trajnim në situata të reja emergjente. Sido që të jetë, edhe unë po pajtohem me kryetarin që t'i ftojme dy ministrat dhe t'i marrim sqarimet e nevojshme.

Goran Marinković- Unë nuk i kam përcjellë mediat dhe nuk jam i informuar për një marrëveshje të tillë. Por jam i befasuar se si një dokument i tillë i diskutuar në mes të dy ministrave së pari ka dal në media. Ju e keni përkrahjen time për vendimet që merren këtu. Po ashtu besoi se është një qëllim i mirë midis dy ministrave, por gjatë takimit të radhës do t'i sqarojmë dyshimet tona. Por, pyetja e ime është se kush ka mundur një dokument të tillë t'ua japë mediave dhe pse një dokument i tillë është vonuar të vijë në Komision për diskutim.

Anton Quni – Mendoj se ky takim është në përputhshmëri të plotë me një nen të kushtetutës të Republikës së Kosovës, ku thuhet; Institucionet e Kosovës e mbrojnë sigurinë publike dhe të drejtat e të gjithëve në Republikën e Kosovës. Unë mendoj se me këtë qasje ne sigurojmë transparencë në monitorimin e institucioneve të sigurisë dhe po ashtu duhet të kërkojmë që edhe institucionet e sigurisë të jenë transparente, si ndaj Komisionit, Parlamentit dhe qytetarëve. Është fakt që publikimet në media, kanë krijuar konfuzion. Po ashtu është e mundshme që ndonjë paragraf i këtij memorandumit të jetë nxjerrë nga konteksti, të cilat pastaj mund të krijojnë konfuzione. Por, në takimin e ardhshëm, besoi që do t'i sqarojmë të gjitha.

Vjollca Krasniqi – Mendoj se askujt nuk do t'i mohohet e drejta që të prononcohet për media, por edhe nëse do të ketë atëherë gjithçka do të jetë në bazë të diskutimeve që i

bëmë këtu, sepse ne nuk kishim ndonjë dokument për ta diskutuar. Edhe pse unë mendoj se këtë dokument nuk ka mundur ta gatuaj dikush tjetër, por është produkt i këtyre dy ministrave. Por, sido që të jetë të presim deri të mërkurën t'i marrim sqarimet e nevojshme nga ministrat. Po pajtohemi që të mërkurën në orën dhjetë t'i kemi këtu për sqarim dy ministrat.

Kryetari- Pra, po pajtoheni t'i kemi ministrat. Po ashtu duhet ta diskutojmë edhe punën e tyre në mënyrë që dokumentet e tilla të mos dalin në media dhe Komisioni të mos jetë në dijeni për një dokument të tillë. Konsideroj që ajo që është institucionale duhet të përfillet, ndërsa ato që janë publike, mediatike, duhet të jenë të pasqyruara sa më mirë. Në mënyrë që t'i heqim këto dilema do t'i kemi ministrat në takim.

Mbledhja përfundoj në orën: 14:00.

E hartoi:

Njësia Mbështetëse e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi